



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjilanit
Opština Gnjilane
Municipal Gjilan
Gilan Belediyesi

D R E J T O R I A P Ë R B U J Q Ë S I D H E P Y L L T A R I

Ankandi me nr.02/2011 të shpallet në shtypin ditor të datës 18.08.2011

Ne mbeshtetje të Ligjit për Pyjet e Kosovës nr.2003/3, ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr.2004/29 për Pyjet e Kosoves, Udhëzimit Administrativ, nr. 06/2010 lidhur me shitjen e trugjeve pyjore dhe asortimenteve drusore, Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari në Gjilan, shpallë:

A n k a n d i n nr. 02/2011

Me të cilin ftohen të gjithë operatorët ekonomik të licensuar, që janë të interesuar për blerjen e masës drusore të deponuara - stivuara në depon e Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari në Gjilan dhe të gjitha asortimenteve drusore që do të konfiskohen gjat vitit 2011 dhe 2012

a). Tabela nr.1. Asortimentet drusore të deponuara në depon e Drejtorisë për Bujqësi dhe Plltari

Lloji i drurit	Sasia-m ³		Çmimi fillestar Euro/ m ³		Vlera fillestare\€
	Teknik	Zjarri	Teknik	Zjarri	
Ahu,bungu etj	4,00	100,00	60,00	30,00	3.240,00

b). I njejt operator, duhet të pranojë në mënyrë permanente, të gjitha asortimentet drusore , që do të konfiskohen gjat vitit 2011 dhe deri në fund të vitit 2012.

c). Drutë e konfiskuara, pas konfiskimit nga autoritetet e Drejtorisë Komunale për Bujqësi dhe pylltari, direkt duhet të vendosen ne depon e operatorit të kontraktuar

d). Operatori fitues i tenderit-ankandit, duhet të posedojë depo të përshtashme për vendosjen e të gjitha druve që konfiskohen gjat periudhës së lartëcekur. Depoja duhet të ketë roje gjat 24 orëve të ditës.

e). Drutë e konfiskuara duhet të qëndrojnë të pa prekura, në depo, deri sa të kryhen të gjitha procedurat eventuale gjyqësore etj.

f). Dorëzimi i druve operatorit përfitues të tenderit\ankandit, bëhet nga komisioni profesional i Drejtorisë edhe ate afërsisht një herë në muaj.

g). Asortimentet drusore, nuk mund ti shfrytëzojë operatori para se ti paguaj ato.

Të gjitha ndërmarrjet të cilat nuk i kanë përmbushur obligimet nga kontratat e më hershme me APK-në nuk do të jenë në konkurrencë për të fituar në këtë tender.

Kriteret për të konkuruar në tender/ankand janë:

- a) Certifikatën e Regjistrimit te Biznesit.
- b) Dëshminë për përgatitjen profesionale dhe teknike- licencën për kryerjen e aktiviteteve përkatëse sipas U.A nr;03/2008 për përcaktimin e kriterëve dhe procedurat për dhënien e licencave për kryerjen e punëve në pyje dhe toka pyjore të dt;06.03.2008.
- c) Certifikatën mbi kryerjen e obligimeve tatimore nga Administrata Tatimore e Kosovës jo më të vjetër se tre muaj, nga dita e aplikimit.
- d) Dëshmi të lëshuar nga Autoriteti Pyjor Komunal në Gjilan, dhe Agjencioni Pyjor i Kosovës, Drejtoria Kordinuese Gjilan se kundër subjektit përkatës nuk ka të ngritur ndonjë procedurë për dëme pyjore dhe se nuk ka obligime të pa kryera nga kontrata të mëhershme.
- e) Dëftesa për pagesën e shumës prej 20,00 Euro për pjesmarrje në ankand/tender.

Kriteret vijuese që do të kërkohen për vlerësimin e ankandit janë:

- a) Çmimi i ofruar për m³ të asortimentit drusor vec e vec për dru zjarri dhe dru teknik.

Subjektet e licencuara që dëshirojnë të marrin pjesë në Ankand Publik, pesë (5) ditë para mbylljes mund të bëjnë vizita në terren në përcjellje të zyrtarëve të Autoritetit Pyjor Komunal.

Për shitjen e asortimenteve të konfiskuara, kriter i vetëm i vlerësimit është çmimi më i lartë i ofruar në tender.

Informatat, detajet, dhe vizitat për çdo ditë mund të merren – në Drejtorinë për Bujqësi dhe Pylltari në Gjilan.

Oferta duhet të përmbajë;

- Vendin e depos dhe sasinë për të cilën paraqitet oferta.
- Çmimin e ofruar për 1m³ të asortimenteve drusore veç e veç për dru zjarri dhe dru teknik.
- Flet regjistrimin e ndërmarrjes.
- Dëshmitë mbi kryerjen e obligimeve tatimore.

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave do të jetë më datën, 02.09.2011, deri në ora 14:00

Ofertat duhet të dorzohen në zyrën e Drejtorisë Komunale për Bujqësi dhe Pylltari në Gjilan, dhe duhet të jenë të mbyllura.

Hapja e ofertave do të bëhet nga komisioni i Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari në prezencë të ofertuesve më datën 02.09.2011, në ora 14:30.

Të gjitha të drejtat dhe obligimet që dalin nga ky tender përcaktohen me Kontratë mes Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari në Gjilan dhe fituesit të tenderit.

Gjilan, 17.08.2011

Drejtori i Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari
Ing. i dipl. Nazmi Rapuca